



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 883/4 Prot.

Tiranë, më 17/7 /2017

REKOMANDIM

Nr. 27, datë 17/7 /2017

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave në ngarkim të kontrolluesit "Tirana Bank", Tiranë:

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 149, datë 05.06.2017, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit, "Tirana Bank", me objekt:

- *Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë përpunimit të të dhënave personale të punonjësve.*

Kontrolluesi "Tirana Bank" ka si objekt të veprimtarisë tregtare atë të ofrimit të shërbimeve financiare. Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave "Punëmarrës" (punonjës), manualisht dhe në format elektronik në rrjetin e brendshëm kompjuterik, për qëllimin e menaxhimit të burimeve njerëzore. Të dhënat personale të punonjësve që përpunohen janë: emër, mbiemër, numër telefoni, e-mail, numri i sigurimit shoqëror, numri personal i identifikimit, jeta profesionale, imazhe nëpërmjet kamerave CCTV, adresa të dhëna për shëndetin, dëshmi penaliteti, certifikatë familjare, fotografi, etj.

1. Zyra e Komisionerit gjatë hetimit administrativ të ushtruar konstatoi se, kontrolluesi "Tirana Bank" nuk i informon në mënyrë të plotë subjektet e të dhënave personale (kandidatët për pozicionin e lirë të punës), pasi në "Formatin e njoftimit për pozicion të lirë pune" nuk reflektohen të gjithë elementet e nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, sa i përket qëllimit dhe mënyrës së përpunimit të të dhënave, të drejtat që gëzojnë në cilësinë e subjektit të të dhënave dhe masat për garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit.

Informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale (kandidatëve për pozicionin e lirë të punës) të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë.

2. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të KDIMDP-së dhe në protokollin e Zyrës së

Komisionerit si edhe nga hetimi administrativ i ushtruar rezultoi se kontrolluesi "Tirana Bank" e ka përmbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr.9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar por u konstatuan mangësi në përditësimin e njoftimit në lidhje me: "*Kategoritë e të dhënave sensitive që përpunohen*" (nuk reflektohet përpunimi i të dhënave për gjendjen penale dhe të dhënave për shëndetin), "*Marrësit e të dhënave personale*" (nuk reflektohet përhapja e të dhënave në shoqërinë e sigurimit).

Detyrimi për të përditësuar njoftimin nëpërmjet "Formularit të Njoftimit" është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin e të dhënave që kryen kontrolluesi dhe të ushtrojnë në mënyrë korrekte të drejtat që u jep ligji.

3. Kontrolluesi në kuadër të garantimit të sigurisë së ambienteve ku ushtron veprimtarinë, ka instaluar një sistem kamerash CCTV në degët ku ushtron veprimtarinë si dhe në ambientet e brendshme të zyrave qendrore. Dy prej kamerave në zyrën qendrore janë pozicionuar dhe marrin imazhe në ambiente të cilat nuk përputhen me qëllimin e mbikëqyrjes në kundërshtim me Udhëzimin nr.3, datë 05/03/2010 të Komisionerit mbi "Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.11, datë 08.09.2011 të Komisionerit mbi "Përpunimin e të dhënave personale të punonjësve në sektorin privat", i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se instalimi i sistemit të kamerave në ambientet e punës së punonjësve çënon privatësinë e punonjësve dhe është në kundërshtim me parimin e mjaftueshmërisë (neni 5 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar) pasi kamerat duhet të konsiderohen si mjete i fundit për të realizuar qëllimin (garantimin e sigurisë).

Në përfundim të hetimit administrativ është mbajtur procesverbali i konstatimit dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të ligjit nr. 44/2015, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", në datën 30.06.2017 është mbajtur seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Kontrolluesi gjatë seancës dëgjimore ka depozituar prova në kuadër të masave të marra në zbatim të ligjit dhe shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e hetimit administrativ, si më poshtë:

- ✓ Është ndryshuar "Formati i njoftimit për pozicion të lirë pune" në përputhje me nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar;
- ✓ Në zbatim të detyrimit për njoftim, nenet 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, është përditësuar formulari i njoftimit në përputhje me konstatimet e grupit të hetimit administrativ;
- ✓ Janë ripozicionuar kamerat që marrin imazhe në ambiente të cilat nuk përputheshin me qëllimin e mbikëqyrjes, në përputhje me Udhëzimin nr.3, datë 05/03/2010 të Komisionerit mbi "Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit mbi "Përpunimin e të dhënave personale të punonjësve në sektorin privat", i ndryshuar.

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 18, 21, 22, 29, 30, 31 pika 1/"a/1" dhe 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi "Tirana Bank", në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të ketë në vëmendje përmbushjen në vazhdim të detyrimit për informim të subjekteve të të dhënave personale, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë;
2. Kontrolluesi "Tirana Bank", në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit, për të gjitha ndryshimet e mundshme në përpunimin e të dhënave personale në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
3. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 17/7 /2017

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI